



Në bazë të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40, shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", dispozitave të Ligjit Nr-03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës", Nr-27/2008", e në mbështetje të Rregullores për tarifë ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale, 01-Nr-12102, të datës 01.12.2015, nenit 28 paragrafi 2 pika (c), nenit 29 paragrafi 2 pika (d) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me 23.03.2027, miraton këtë:

## V E N D I M

Për faljen e borxhit të pa paguar për taksën në aktivitet

### Neni 1

Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar **për taksën në aktivitet**, për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Suharekës nga data **01.01.2000** deri me **31.12.2012**.

### Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për taksën në aktivitet, të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfitues nga periudha e cekur në nenin 1, të këtij vendimi nga zyrtaret përgjegjës të Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet, e Komunës së Suharekës, përkatësisht sektori financiar.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-11838  
Më datë 24.03.17



Kryesuesi i Kuvendit

Refa GEGA